



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:1710/24 Datë: 20.08.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 127 të mbajtur më datë 12.08.2024 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

I. Nuk riakreditohet programi i studimit i Kolegjit Biznesi kampusi kryesor në Prishtinë, programi:

- *Juridik LLB 240 ECTS (R).*

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji Biznesi brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Juridik LLB 240 ECTS (R).</i>	Muhamet Binaku Mitasin Beqiri Sehdefa Gjafqe Sedat Ismajli

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit AKA ka organizuar vizitat në Kolegjin Biznesi kampusi kryesor në Prishtinë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit: *Johannes Falterbaum, Peter Parycek dhe Christoph Back.*

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Për këtë program të studimit; *Juridik LLB 240 ECTS*, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 27.06.2024, të cilën kanë konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Substancialisht vetëm dy (2) standarde, Pjesërisht i përmbushë katër (4) ndërsa Nuk ka përmbushje të standardit (1) fushë të standardeve të akreditimit.

Për shkak të mungesës së përmbushjes së fushave Plotësisht dhe numrit të vogël të fushave të standardeve (dy fusha) të përmbushura Substancialisht në vlerësimin e programit *Juridik LLB 240 ECTS*, KShC ka vendosur të mos riakreditohet programi në fjalë.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 127-të, të mbajtur më datë 12.08.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegjit Biznesi dhe duke u bazuar në raportin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*



Prof. Asoc. Dr. Hashija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Biznesi kampusi kryesor në Prishtinë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.